




2-D/DPK1

02

01-878/2012
05.03.2012

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.02.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me nr.AKK- 03-3991/11, për z.Gëzim Bxhaku, Këshilltarë Politikë në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Enërgjisë dhe Minierave, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihaqet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt te interesit me numër protokolli AKK-03-3991/11, qe ka të bezë me z.Gëzim Baxhaku, Këshilltarë Politikë në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Energijsë dhe Minierave, janë zhvilluar të gjitha procedurat për të vërtetuar gjendjen e konfliktit të interesit.

Lënda për zyrtarin e lartë z.Gëzim Baxhaku është e trajtuarë edhe në vitin 2010, dhe është kërkuar nga ai që të shmangë konflktin e interesit, pasi qe ishte në gjendje te mundëshme te konflktit te interesit.

Zyrtari i lartë z.Gëzim Baxhaku ka sjellur dokumentacionet që ka bërë ndryshimet e kërkuara në Biznesë, ku është larguar nga pozita e personit te autorizuar në kompani dhe ka emruar një person tjetër si person te autorizuar dhe ka mbetur vetëm si aksionarë pa e sqaruar se kush është personi i emruar si person i autorizuar.

Pasë kësaj procedure është nxjerrë vendim për mbylljen e rastit, pas shmangiës se konfliktit të mundshëm te interesit në atë kohë.

Me datën 28.10.2011, ka ardhur informata se z.Baxhaku në kompanin e tij ku është njeri nga aksionarët, përsone të autorizuar ka emruar vajzën e vetë znj.Azra Baxhaku.

Menjeherë pasi është analizuar informata janë ndermarrë të gjitha veprimet për te vërtetuar ketë gjëndje dhe është konstatuar se në ndryshimet e më hershme qe i ka bëre në biznesë, z.Gëzim Baxhaku dhe aksionari tjetër kanë emuar znj.Azra Baxhaku si person te autorizuar ne biznesë.

Procesi ka vazhduar duke e njofuar zyrtarin e lartë z.Gëzim Baxhaku se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjës se konfliktit të Interesit, z.Baxhaku menjeher ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë dhe jemi takuar, ku i kemi perezentuar faktet qe posedojmë, zyrtari i lartë z.Gëzim Baxhaku është pajtuar me gjëndjen, mirëpo është arsytaur se nuk ka qenë në dijeni se nuk ka pasë të drejtë ta emroj vajzën e vetë si person, të autorizuar në kompani pas ndryshimeve të bëra në biznesë.

Pasë zhvillimit të procedurës, z.Gëzim Baxhaku i është kërkuar që ta shmangë ketë gjendje dhe me datë 22.02.2012, ka sjellur në Agjenci dokumentacionin ku bashkë me aksionarin tjetër kanë emruar nje person tjetër si personë të autorizuar në kompani.

Konstatojmë se pasë ndryshimeve të bëra në biznesin e tij zyrtari i lartë z.Gëzim Baxhaku ka shmangur gjendjën e konfliktit të Interesit.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

